

VENDIM
Nr.48, datë 16.1.2008

**PËR MASËN DHE KRITERET E PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I NXITJES SË
PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NGA GRUPET E VEÇANTA**¹

*(Ndryshuar me VKM nr.991, datë 2.7.2008; nr.923, datë 10.11.2010; nr.772, datë 7.11.2012;
nr.192, datë 2.4.2014; nr.461, datë 9.7.2014; nr.66, datë 27.1.2016; nr.175, datë 28.3.2018)*
(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe formimit profesional, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkuesit e papunë nga grupet e veçanta, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) Punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit.

Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në degën përkatëse të tatimeve, sipas procedurave përkatëse;

b) Punëmarrësin e përfshirë në këtë program, deri në katër paga, në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e pestë e të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

c) Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës.

ç) Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program deri në 40 për qind të numrit të punonjësve të punësuar.

2. Programi të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2018 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 5 (pesë) vjet.

3. Punëkërkues të papunë nga grupet e veçanta janë:

a) të papunët afatgjatë;

b) personat, që përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) personat, që përfitojnë pagesë papunësie;

ç) personat, që hyjnë për herë të parë në tregun e punës, të moshës 18-25 vjeç;

¹ VKM nr. 48, datë 16.1.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, 30 janar 2018.
VKM nr. 991, datë 2.7.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 117, 24 korrik 2008.
VKM nr.923, datë 10.11.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.170, 20 dhjetor 2010.
VKM nr.772, datë 7.11.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, 22 nëntor 2012.
VKM nr.192, datë 2.4.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.46, 8 prill 2014.
VKM nr.461, datë 9.7.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 112, 21 korrik 2014.
VKM nr.66, datë 27.1.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.13, 5 shkurt 2016.
VKM nr.175, datë 28.3.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, 3 prill 2018.

d) personat mbi 45 vjeç, që nuk kanë një arsimim më të lartë se arsimi i mesëm ose ekuivalent të tij;

dh) personat me aftësi të kufizuar;

e) personat nga komuniteti rom;

ë) *emigrantët e kthyer me probleme ekonomike.*

f) *viktima të trafikimit.*

4. Financimi sipas pikës 1 ndërpritet në rastin kur punëdhënësi, pas përfitimit të financimit, në zbatim të këtij vendimi, zgjidh, pa shkaqe të arsyeshme, kontratat e punës së punëmarrësve të tjerë, të punësuar pranë tij.

5. Zyra përkatëse e punësimit bën njoftimin në Buletinin e Njoftimeve Publike, çdo vit, për fondin e vënë në dispozicion dhe kriteret e përfitimit nga ky program. *Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.*

6. Punëdhënësi, që aplikon për programin e punësimit, nuk duhet të ketë shkelur, në të kaluarën legjislacionin e punës si dhe duhet të ketë derdhur, rregullisht, tatimet e sigurimet e detyrueshme shoqërore, për aq kohë sa kryen veprimtarinë, veçanërisht për dy vitet e fundit.

7. *Për të përfituar nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës së punësimit ose të ngarkojë në mënyrë elektronike dokumentet e mëposhtme:*

a) *Vetëdeklarimin dhe autorizimin për të lejuar nëpunësin përgjegjës të gjenerojë online dokumentacionin e nevojshëm;*

b) *Planin e biznesit të detajuar;*

c) *Dokumentacionin justifikues për rastet e detyrimeve ndaj organeve tatimore, por që vërtetojnë se në momentin e aplikimit në këtë program:*

i) *kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;*

ii) *kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjambat;*

iii) *kanë shlyer detyrimet ose kanë vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit, në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe janë në proces të apelimit administrativ dhe në procese gjyqësore me organet tatimore.*

8. Zyra përkatëse e punësimit duhet të sigurojë për secilin punëdhënës aplikues dokumentacionin e mëposhtëm:

a) *Ekstraktin historik të personit fizik apo juridik, që aplikon për programin, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;*

b) *Vërtetimin për pagimin e detyrimeve tatimore;*

c) *Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit, të specifikuar për tre muajt e fundit.*

Zyra përkatëse e punësimit është përgjegjëse për plotësimin e dosjes së aplikimit.

9. *Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.*

10. Zyra përkatëse e punësimit ia paraqet këshillit vendor tripalësh, të ngritur pranë saj, projektet, që kërkohen të zbatohen aty, ky ajo ushtron veprimtarinë, i cili pasi shqyrton dhe vlerëson dobinë social-ekonomike të projekteve të paraqitura, i miraton ato në parim.

11. Pas miratimit, në parim, të projekteve në këshillin vendor tripalësh, zyra përkatëse e punësimit i dërgon, për miratim, si më poshtë vijon:

a) zyra vendore e punësimit, sipas rastit, ia dërgon zyrës rajonale të punësimit ose Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur *aplikuesit janë persona fizikë.*

c) *Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit miraton projektet, kur aplikues janë personat juridikë.*

12. Për zbatimin e pikës 11 të këtij vendimi, në zyrat rajonale të punësimit dhe në

Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihen komisionet e miratimit të projekteve, me jo më pak se 5 persona.

Mënyra e organizimit, vlerësimit të projekteve dhe e funksionimit të punës, si dhe përbërja e komisioneve përcaktohen në rregulloren e këshillit administrativ tripalësh të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

13. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit pas hedhjes në sistemin përkatës, vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

14. Për projektet e miratuara, zyra përkatëse e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuësve të papunë, që do të përfshihen në program. Punëkërkuësit e papunë, që do të përfshihen në program, sipas shkronjave “d” dhe “e” të pikës 3 të këtij vendimi, duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit.

Punëkërkuësit e papunë, që kundërshtojnë të marrin pjesë në këtë program, hiqen nga lista e punëkërkuësve të papunë dhe nuk do të vazhdojnë të përfitojnë ndihmën ekonomike apo pagesën e papunësisë.

15. Ndërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, në përputhje me programin për secilën palë. Kontratat lidhen vetëm për vitin buxhetor, për të cilin është miratuar projekti.

Për vazhdimin e projektit në vitin pasardhës do të lidhet një kontratë shtesë, në përputhje me fondet e miratuara atë vit.

16. Punëdhënësi dhe punëkërkuësi, si punëmarrës, nënshkruajnë një kontratë individuale pune, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe në këtë vendim.

Një kopje e kontratës së punës së çdo punëkërkuësi, punëmarrës, depozitohet në zyrën përkatëse të punësimit e cila ndjek zbatimin e kontratës deri në përfundim të projektit.

17. Në rastet kur punëkërkuësi, si punëmarrës, pjesëmarrës në këtë program, largohet përpara afatit të përcaktuar në kontratë, për shkaqe të arsyeshme, zëvendësimi bëhet nga zyra përkatëse e regjistrimit pas njoftimit nga punëdhënësi. Në këto raste, punëdhënësit i vazhdohet kompensimi për periudhën e mbetur.

18. Nëse punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe bën zgjidhjen e arsyeshme të kontratës së punës, për punëkërkuësin e punësuar, është i detyruar ta kthejë të gjithë financimin e marrë, për punëkërkuësin e punësuar, që nga data e parë e dhënies së tij, së bashku me interesat, të llogaritura sipas normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

19. Kontratat tip, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 15 e 16 të këtij vendimi, hartohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga zyrat përkatëse të punësimit.

20. Shërbimi Kombëtar i Punësimit analizon efektshmërinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional dhe Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore, në struktura përgjegjëse e ndihmës shtetërore.

21. Shërbimi Kombëtar i Punësimit ruan të dhënat për skemën deri në 10 vjet, pas dhënies së fundit të ndihmës individuale.

22. Programi vlerësohet, në vitin pasardhës nga ekspertë ose organizata të pavarura, që kanë përvojë në këtë fushë dhe njohuri për tregun e punës.

23. Kostoja dhe vlerësimi i këtij programi përballohen nga fondet vjetore të Buxhetit të Shtetit, zëri “Nxitja e punësimit”, miratuar për ministriinë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional.

24. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e programit, nëpërmjet zyrave të punësimit.

25. Vendimi nr.69, datë 11.2.1999 i Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha